

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 831 REP.

Nr. 369 KOL.

Tarifa e pullës u lëvizës



KONTRATË SHITJE
e Kuotave të Kapitalit

Në Tiranë sot, më datë 27 Korrik 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres **MARIANA DAKA**, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë noteriale Rruga "Emin Duraku", Pallati 3/1, me NIPT L42125011B, u paraqitën personalisht, palët e poshtëshënuara, të cilët me vullnetin e tyre të lirë, ranë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë Shitje të Kuotave të Kapitalit:

SHITËSI: **Z. Ylvi Kodra**, atësia Maliq dhe amësia Aida, i datëlindjes 27.08.1988 lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. Vildan Luarasi Nr.12, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 024417635 dhe me numër personal I80827063L, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "**Pala SHITËSE**".

BLERËSI: **Z. Alban Laçi**, atësia Ferdinand dhe amësia Yllka, i datëlindjes 28.07.1988, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. "Siri Kodra" Pallati 92/1, Ap.3, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me numër BD2204721 dhe me numër personal I80728067W, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "**Pala BLERËSE**".

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë KONTRATË SHITJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT, sipas kushteve dhe kritereve të mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria "E - KOMPLET" Shpk, person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 16.01.2018, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, filiali Tiranë dhe e pajisur nga kjo zyrë me Çertifikatë Regjistrimi dhe Numër Identifikimi (NUIS) L81316036S, me seli në adresën: Njesia bashkiake nr. 8, rruga Siri Kodra, nr.80, Tiranë, Shqipëri, me një kapital themeltar në shumën 500'000/0 (Pesëqind mijë) Lekë, me ortakë të saj: Z.Alban Laçi, që zotëron 80% (tetëdhjetë përqind) të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë dhe Z.Ylvi Kodra, që zotëron 20% (Njëzet përqind) të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë dhe, që të dy së bashku përbëjnë 100%(njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria "E - KOMPLET" Shpk, drejtohet nga Administratori Ligjor i Shoqërisë Z.Ylvi Kodra.

Ortaku themelues Z.Ylvi Kodra, kërkon të kalojë nëpërmjet shitjes 20% të kuotave të kapitalit të tij në shoqërinë "E - KOMPLET" Shpk, brenda shoqërisë, tek ortaku Z.Alban Laçi, sipas kushteve dhe kërkesave të parashkruara në këtë kontratë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "E - KOMPLET", nëpërmjet vendimit të datës 26.07.2018, ka vendosur të miratojë kërkesën e shitjes së 20% të kuotave të zotëruara nga ortaku Z.Ylvi Kodra, brenda shoqërisë, tek ortaku Z.Alban Laçi.

Paraprakisht, palët kontraktore kanë bërë verifikimin mbi gjendjen juridike të kuotave të zotëruara nga Shitësi, pas verifikimit të të cilave rezultoi se ato janë tërësisht të lira nga çfarëdolloj barre apo detyrimi në favor të të tretëve.

Meqë ekzistojnë kushte paraprake, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, palët, me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e Kuotave, pjesë e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "E - KOMPLET" SH.P.K., (këtë e tutje si "Kontrata"), sipas kushteve të mëposhtme:

OBJEKTI I KONTRATËS

Me anë të kësaj kontrate, pala Shitëse, Z.Ylvi Kodra, i cili zotëron në total 20% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "E - KOMPLET" Shpk, me dëshirën e tij shet dhe transferon brenda shoqërisë, palës Blerëse, ortakut, Z.Alban Laçi, i cili pranon dhe blen 20% të kuotave të pjesës takuese të kapitalit të zotëruar nga shitësi në totalin e kapitalit themeltar të Shoqërisë "E - KOMPLET" Shpk, kuota tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të tretëve, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to.

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGIMIT

Shitësi, Z.Ylvi Kodra i shet palës blerëse, Z.Alban Laçi, 20% të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin e shoqërisë "E - KOMPLET" Sh.p.k, ose përkatësisht 1(një) kuotë të zotëruar prej tij, me vlerën totale prej 100'000 (Njëqind mijë) Lekë, vlerë për të cilën pala shitëse nuk ka asnjë pretendim, të tashëm apo të ardhshëm mbi to dhe për të cilën deklaron se është likuiduar totalisht. (Bashkëlidhur Mandati Bankar.)

KALIMI I PRONËSISË

Që nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotave, Shoqëria "E - KOMPLET" Sh.p.k, do të ketë një ortak të vetëm :

Z.Alban Laçi, i cili do të zotërojë 100%(Njëqind përqind) të kuotave nominative në kapitalin themeltar të shoqërisë.

GARANCITË

Blerësi, me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, do të përfitojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet në masën prej 100%(Njëqind përqind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë, të reflektuar në bazë të pasqyrave financiare dhe të bilancit të shoqërisë. Për këtë qëllim, blerësi deklaron se do të analizojë dhe do të verifikojë, për të miratuar situatën pasurore, financiare dhe kontabile të shoqërisë, pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Shitësi garanton Blerësin se kuotat objekt kontrate, nuk janë objekt pengu dhe janë të lira nga çdo lloj titulli e natyre të të tretëve.

BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu si dhe për trashëgimtarët e tyre.

HARTIMI I KONTRATËS

Kontrata përbëhet nga 3(tre) fletë dhe hartohet në 4(katër) kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe dhe angleze. Çdonjëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë një kopje. Dy kopjet e tjera, një e mban Noterja dhe kopja e katërt depozitohet për regjistrim në zyrën e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, filiali Tiranë.

HYRJA NË FUQI E KONTRATËS

Detyrimet dhe të drejtat, që burojnë nga kjo Kontratë, fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Unë Noterja, pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë palëve, tekstin e kësaj kontrate, konstatova se ata e gjetën përmbajtjen e saj, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, duke e nënshkruar atë rregullisht para meje, dhe unë, Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

PALËT KONTRAKTORE


SHITËSI

Z.Ylvi Kodra

YLVI KODRA


BLERËS

Z.Alban Laçi

ALBAN LAÇI




NOTERE

Mariana Daka



Mariana Daka


Banka Kombëtare Tregtare : 27-JUL-2018 15:41

TRANSFERIM NGA LLOGARIA NE LLOGARI
ACCOUNT TO ACCOUNT TRANSFER



KLIENTI: 425696736
EMRI I KLIENTIT: YLVI MALIQ KODRA
ADRESA E KLIENTIT: RR VILDAN LUARASI NR 12
1001 TIRANE
PAGA E-KOMPLET SHPK

REFERENCE : 425TAAT182080066
DATE VALUTA/VALUE DATE : 27-JUL-18

LLOGARIA E VEPRIMIT/TXN ACC : 425696736SAVAIDALLPU
IBAN : AL27 2051 1258 6967 36SA VAID ALLP
EMËRTIMI I LLOGARISË/ACC DESC : YLVI MALIQ KODRA
SHUMA E VEPRIMIT/TXN AMOUNT : 100,000.00 ALL
OFS ACC : 434000073CLIDCLALLIB
EMËRTIMI I LLOGARISË/ACC DESC : ALBAN FERDINAND LACI
OFS AMOUNT : 100,000.00 ALL
KURSI I KËMBIMIT/EXCH RATE : 1

NR.I CEKUT/CHEQUE NO :
KODI I BANKËS/CLG BANK :

PËRMBLEDHJE E KOMISIONIT/CHARGE/TAX SUMMARY

SHUMA BAZE/BASE AMT : 100,000.00 ALL
TOT TAX : 0.00 ALL
KOMISIONI/TOT CHG : 100.00- ALL

SHUMA NETO/NET AMT : 100,100.00 ALL

BURIMI I TË ARDHURAVE :

PËRSHKRIMI I VEPRIMIT :
ALBAN FERDINAND LACI PER YLVI MALIQ KODRA SHITJE KUOTASH E KOMPLET SHPK

KLIENTI : EMËR MBIEMËR FIRME

ALBAN LACI

Unë konfirmoj me nënshkrimin e këtij mandati se të dhënat e printuara janë të sakta sipas kërkesës time. Ky mandat do të shërbejë si provë për çdo pretendim në të ardhmen.

***** Sipas Kushteve të Punës në fuqi *****

Punonjësi i degës:



REZULTATET E KËRKIMIT



Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20180727134629510
Data e Rezultatit të Kerkimit: 27.07.2018
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 1:46:29PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-517-52
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

E - KOMPLET SH.P.K.



Ela Kamoni